

Dr. Ardit BIDO

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Shqipëri

SFIDAT E PËRPUNIMIT TË DOKUMENTACIONIT NË RRJETIN ARKIVOR KOMBËTAR

Sfida kryesore e rrjetit arkivor në cilindo vend është përmbushja e misionit bazë të tij, ruajtjes së memories kolektive kombëtare. Në këtë kuptim, sfida e përpunimit dhe dorëzimit të rregullt të *dokumentacionit* arkivor **duhet** të vlerësohet si çështja më e rëndësishme, pasi pa bazën e vetë, lëndën arkivore, arkivat nuk do të ekzistojnë. Në këtë kumtesë do të pasqyroj gjendjen aktuale të dorëzimit të dokumentacionit në Arkivin Qendror Shtetëror, dorëzimin e dokumentacionit të papërpunuar, bazën ligjore dhe propozime për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Problemet në rrjetin arkivor janë dy: së pari, mosdorëzimi i dokumentacionit në arkivin e përhershëm brenda kufijve kohorë të përcaktuar në ligjin “Për Arkivat” dhe së dyti, dorëzimi i tyre të papërpunuara në AQSH, duke rritur artificialisht barrën e arkivit dhe duke e denaturuar atë. Shumica e institucioneve qendrore shtetërore në Shqipëri nuk e dorëzojnë lëndën arkivore të përpunuar në afat. Vonesa në dorëzim varion nga pak vite, deri në dekada, duke bërë që memoria kolektive kombëtare të pësojë stanjacion. Ekzistojnë raste, si Ministria e Bujqësisë, dhe institucione të tjera që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të përpunuar që prej vitit 1991. Për më tepër, vetëm një institucion, Akademia e Shkencave, e dorëzon lëndën arkivore me përpikmëri, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj. Në komunikimet shkresore me institucione të ndryshme qendrore, vërehet mosnjohje totale e konceptit të dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, ku shumë prej tyre theksojnë se nuk kanë asnjë dokument RHK, çka është objektivisht e pamundur.

Problemi i dytë që ka të bëjë me dorëzimin e dokumenteve të papërpunuara në AQSH është po aq shqetësues. Puna e vetme që janë angazhuar për vite me rradhë sektorët e përpunimit në DPA është sistemimi i fondeve të papërpunuara të institucioneve shtetërore, në shkelje flagrante të nenit 42, të Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ku përcaktohet se dokumentacioni arkivor dorëzohet në arkivat shtetërore të sistemuara dhe të inventarizuara. Neni 46 i Ligjit përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka të drejtë të tërheqë dokumentet e përpunuara, në rast rreziku të dukshëm, por shpenzimet për përpunimin arkivor të tyre përballohen nga institucionet fondkrijuese kur ekzistojnë, ose institucioni trashëgimtar a i burimit të varësisë, kur fondkrijuesi nuk ekziston.

Dokumentet e papërpunuara sot në AQSH janë dorëzuar në mënyrë të jashtëligjshme: një pjesë pa marrëveshje, një pjesë pa procesverbal dhe pjesa tjetër me marrëveshje që është bazuar pjesërisht ose aspak. Kjo problematikë është

akumuluar nga viti 2000 deri në vitin 2011. E vetmja marrëveshje funksionale është mes DPA-së dhe Ministrisë së Transporteve e vitit 2015. Si rrjedhojë, në Arkivin Qëndror Shtetëror, janë pranuar të papërpunuara rreth 3500 metër linear dokumentacion, ndërsa në Arkivat Qendrorë Shtetërorë Vendorë rreth 500 metër linear dokumentacion. Në bazë të normave të punës, një specialist do të donte 800 vite për të përfunduar këtë proces. Ndërkohë, që nëse të gjithë arkivistët merren me këtë sistemim dhe nuk merren me funksionet e tyre, do të duheshin më shumë se 50 vite. Kjo ka sjellë bllokimin e proceseve ligjore të punës, dëmtimin fizik të arkivave, rrezikun e rrjedhjes së informacionit të klasifikuar, mospasjen e mjediseve fizike të mjaftueshme për dokumentacionin arkivor të pranuar ligjërisht e problematika të tjera. Vlen të theksohet se e njëjta situatë vlen për arkivat e sistemit.

Në mënyrë që të mund të tejkalohen këto problematika nevojitet që problemet e evidentuara në pjesën e parë të kësaj kumtese, të shoqërohen me zgjidhje konkrete. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si institucioni epror i rrjetit arkivor kombëtar ka detyrën bazike t'i japë zgjidhje kësaj gjendjeje, që rrezikon dukshëm që historianët e pas 100 viteve, të kenë më të thjeshtë të shkruajnë historinë e viteve '30 sesa historinë e viteve '90-2000.

Arsyet e kësaj gjendjeje janë të shumta. Përtej arsyeve subjektive, të neglizhencës dhe mosmarrjes seriozisht të sektorëve të sekretari-arkivave, mundet të evidentojmë disa probleme objektive, që kanë nevojë të trajtohen dhe të marrin zgjidhje. Së pari, ndryshimi i shpeshtë i arkivistëve dhe emërimi i individëve që nuk kanë përvojë në arkivistikë, duke penguar zhvillimin e procesit të punës. Së dyti, mosrespektimi i kornizës procedurale të punës në arkiva, që nis nga miratimi vjetor i pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve, ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Ekspertizës, miratimi i listave konkrete të afateve të ruajtjes të dokumenteve RHK, etj. Së treti, pamundësia burokratike e institucioneve për të pasur më shumë punonjës në sekretari-arkiv, bazuar në volumin e dokumentacionit, çka parashihet, por pa u detajuar, në ligjin “Për Arkivat”.

Në mënyrë që kjo problematikë masive të zgjidhet nevojiten ndërhyrjet e nevojshme në procedura dhe rregulla, shoqëruar me një inspektim të mirëfilltë, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat që jep ligji “Për arkivat” prej vitit 2003. Modelet evropiane janë të ndryshme dhe problematika e mospërpunimit të dokumentacionit është e kudondodhur në Evropën Lindore gjatë periudhës së tranzicionit pas rënies së regjimit komunist. Ndër modelet më të suksesshme janë vendet Baltike, të cilat kanë arritur të krijojnë një cikël të mbyllur nga procedurat deri te rregullimi, duke shmangur rrezikun e dëmtimit të memories shkresore.

Së pari, zgjidhja e nevojshme duhet të përfshijë procedura të qarta për punën me dokumentet nga institucionet shtetërore, për të ndihmuar arkivistët dhe titullarët e institucioneve me detyra dhe afate konkrete për realizimin e tyre. Në këtë kuadër, Këshilli i Lartë i Arkivave ka miratuar “Rregulloren njëesuese

të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, si një dokument, që përmban ndarje të qartë të detyrave dhe akteve administrative që duhen përgatitur dhe miratuar, si edhe sasinë e dokumenteve që duhen përpunuar çdo vit. Rregullorja cakton afate për realizimin e detyrave për punën me dokumentet. Për më tepër, ajo jep mundësinë që të dallohet pa vështirësi rastet kur moszbatimi i detyrave që rrjedhin nga kjo rregullore dhe Normat Tekniko-Profesionale është përgjegjësi e sekretari-arkivit apo e titullarit të autoritetit publik. Rregullorja përbën aktin juridik që plotëson kuadrin ligjor të punës me dokumentet, si detajim i Normave Tekniko-Profesionale të Republikës së Shqipërisë, që është akt nënligjor i tagruar drejtpërsëdrejti.

Së dyti, nevojitet inspektimi rigoroz dhe garancia që rregullat në fuqi zbatohen nga institucionet shtetërore. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave po përgatit kapacitetet për zhvillimin e inspektimeve, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo, pasi deri më sot, ajo nuk ka zhvilluar inspektime, sipas ligjit, edhe pse ka pasur Drejtori Inspektimi dhe inspektorë. Kjo drejtori ka kryer ndihmë metodike dhe kontrole rekomanduese ndaj institucioneve, por asnjëherë nuk ka përcaktuar veprime detyruese ndaj tyre dhe as ka aplikuar gjoba ndaj kundravajtësve, siç përcakton ligji “Për Arkivat”. Kështu, prej prillit të këtij viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është njohur si inspektoriat i 16-të shtetëror, nëpërmjet nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360 “Për rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”. Gjatë këtij viti, DPA po përgatit kapacitetet njerëzore, listat e verifikimit, procedurat e inspektimit online dhe po trajnon inspektorët me ndihmën e Inspektoriatit Qendror, në mënyrë që prej vitit të ardhshëm të nisin inspektime të mirëfillta me përcaktime detyruese për institucionet shtetërore dhe gjoba ndaj kundravajtësve të ligjit.

Së treti, nevojitet garancia që arkivistët të cilët punësohen në autoritetet publike të kenë njohuritë dhe aftësinë e nevojshme për të qenë në lartësinë e duhur të punës së tyre, duke shmangur prapambetjen e përpunimit të dokumentacionit. Në këtë drejtim vlen të shihen mundësitë e disa ndryshimeve, duke marrë përvojën e vendeve evropiane. Për shembull, arkivistika është profesion i rregulluar në Letoni, ku të interesuarit për t’u punësuar si arkivistë duhet të kalojnë testin kombëtar dhe të marrin licencën e arkivistit. Një ndryshim i tillë duket i vështirë në Shqipëri, teksa numri i profesioneve të rregulluara është shumë i vogël dhe për të nevojiten ndryshime ligjore. Nëse kjo nuk realizohet, një mundësi jetër do të ishte vendosja e masterit në arkivistikë, ose e shkollimit në shkenca shoqërore shoqëruar nga trajnimet e zhvilluara nga DPA, si kriter skualifikues për punësim në administratën shtetërore. Po ashtu, trajnimi dhe testimi i vazhdueshëm i arkivistëve dhe largimi i atyre që nuk kalojnë testimet mund të përmirësonte kapacitetet njerëzore në këtë fushë. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka nisur bisedimet me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për zhvillimin e trjanimëve të përbashkëta detyruese dhe periodike për punonjësit e sekretari-

arkivave në administratën publike, me testim përfundimtar për njohuritë e tyre në arkivistikë.

Së katërti, është e nevojshme të garantohet sasia e mjaftueshme e burimeve njerëzore për përpunimin e dokumentacionit. Në bazë të analizave të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, shumë institucione kanë numër punonjës në sekretari-arkivat e tyre më të vogël sesa nevojitet për përpunimin e dokumentacionit në bazë të normave në fuqi. Nga ana tjetër, burimet njerëzore që nevojiten për përpunimin e dokumentacionit të prapambetur janë aq të mëdha saqë është e pamundur të realizohen.¹ Për të tejkaluar këtë problem, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka kërkuar nga institucionet e administratës të vendosin në dispozicion të AQSH punonjës me kontratë për përpunimin e dokumentacionit të dorëzuar në mënyrë të jashtëligjshme. Vetëm gjatë këtij viti janë nënshkruar katër marrëveshje dhe janë vendosur në dispozicion më shumë se 15 punonjës për përpunimin e këtij dokumentacioni. Mirëpo, ky veprim është i pamjaftueshëm për të zgjidhur problematikën. Mundësi tjetër që mund të shihet është përcaktimi i numrit të punonjësve që punojnë në sekretari-arkiv në bazë të sasisë së dokumentacionit, siç përcakton ligji “Për arkivat”. Këshilli i Lartë i Arkivave ka përcaktuar këtë vit formulën e kësaj përlllogaritjeje dhe i ka kërkuar Kryeministrisë dhe Departamentit të Administratës Publike. Mirëpo, ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim që kjo të materializohet.

Së fundmi, licensimi i arkivave private, siç përcaktohet në ligjin “Për Arkivat” do të mund t’i jepte frymëmarrje rrjetit arkivor kombëtar. Edhe pse ligji i përcakton prej vitit 2003, ende nuk është miratuar vendimi i Kësillit të Ministrave për kriteret e licensimit të tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e ka përgatitur projektin dhe e ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave. Sipas projektit, arkivat private janë persona juridikë që plotësojnë kriteret rigoroze për sigurinë dhe kushtet e vendruajtjeve dhe ruajnë, përpunojnë dhe administrojnë dokumentet e institucioneve private që i kontraktojnë. Mirëpo, po

ashtu, ato mund të ruajnë dhe përpunojnë edhe dokumentacionin e autoriteteve publike, për periudhën që dokumentacioni qëndron në autoritetin publik sipas ligjit, me detyrimin që pasi t’i përpunojnë t’i dorëzojnë në arkivin përkatës të përhershëm. Kjo do të përbënte një valvul shfryrëse duke dhënë një mundësi më shumë për autoritetet publike për të përpunuar dokumentacionin e prapambetur, duke garantuar dorëzimin e tyre të përpunuar dhe të shfrytëzueshëm në arkivat e përhershëm.

Këto ndryshime do të mund të koalidonin sistemin, duke mundësuar zgjidhjen e stabilizuar afatgjatë të problematikës në fjalë. Si përfundim, mund të themi se memoria tonë kolektive kombëtare është në rrezik, për shkak të pasojava të gjata të tranzicionit. Mundësitë objektive të arkivave të përhershme

¹ Përlllogaritet se janë më shumë se 30 kilometra linearë të papërpunuara, që u ka kaluar afati i dorëzimit ose janë dorëzuar të papërpunuara në arkivat e përhershme, që do të thotë se nevojitet rreth 400 punonjës për 15 vjet për përpunimin e tyre.

janë të pakta dhe vëmendja shtetërore mungon. Përveç mosnjohjes, institucionet shtetërore kanë edhe pamundësi objektive për t'i dhënë zgjidhje përpunimit brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj. Nga ana tjetër, roli inspektues i DPA-së ka munguar, duke u trajtuar më së shumti si monitorues e ndihmues, sesa si inspektim i mirëfilltë. Zgjidhja e kësaj problematike kërkon ndryshime rrënjësore në konceptin dhe filozofinë e punës së DPA-së, duke u bazuar tërësisht në ligjin për arkivat dhe duke e aplikuar atë me rigorozitet. Kjo arrihet duke krijuar procedura të qarta inspektimi dhe aplikimin e masave shtrënguese administrative dhe gjobave të përcaktuara në ligjin për arkivat, shoqëruar nga arkivat private, që i japin mundësi institucioneve të tejkalojnë çështjet burokratike që pamundësojnë objektivisht realizimin e detyrimeve të tyre ligjore. Po ashtu normimi i numrit të punonjësve në sekretari arkiva dhe miratimi i statusit të arkivistit, do të përbënin koalidimin përfundimtar të rrjetit arkivor kombëtar.